



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.17/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbarimore të kreditorit EXDC-us Sh.P.K., me seli në Prishtinë, lagjia Kalabria, R. Krasniqi, nr.39, të cilën e përfaqëson zyra ligjore Pro Juris, me seli në Prishtinë, kundër debitorit Messier 96 Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. “Fadil Hoxha”, e përfaqësojnë zyra ligjore Pallaska& Associates, me avokat Dastid Pallaska nga Prishtina, çështjen përmbarimore, për shkak të borxhit në bazë të dokumentit përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2130/22 të datës 31.10.2023, më datën 07.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit EXDC-us Sh.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2130/22 të datës 31.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.2130/22 të datës 31.10.2023, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit të përmbarimit Messier 96 Sh.P.K., dhe ka anuluar urdhërin përmbarimor P.nr.135/22 të datës 15.08.2022 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Shala, me seli në Prishtinë dhe ka përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Ankesë ka paraqitur në afat ligjor kreditori dhe atë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe arsytimit të aktvendimit, me propozimin që Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së dytë ta aprovoje në tërësi si të bazuar ankesën e kreditorit, dhe të anulohet aktvendimi i gjykatës shkallës së parë KPPP.nr.2130/22 të datës 31.10.2023 dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar debitori, duke propozuar që të refuzohet në tërësi ankesa e kreditorit dhe të vërtetohet aktvendimit i gjykatës së shkallës së parë KPPP.nr.2130/22 të datës 31.10.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2

të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori EXDC-us Sh.P.K., me seli në Prishtinë, me datën 11.08.2022 ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit Messier 96 Sh.P.K., në bazë të dokumentit përmbarimor – Kontratës për Qira Nr. I LPR: 1159/2017 dhe Nr. Ref. 176/2017 të datës 14.02.2017, për pagesën e detyrimeve në lartës prej 16,769.20€, i cili është dokument përmbarues në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit për Procedurës përmbarimore.

Përmbaruesi Privat, Isa Shala, me seli në Prishtinë, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.135/22 të datës 15.08.2022, ka caktuar përmbarimin, duke vlerësuar se dokumenti përmbarimor Kontratës për Qira Nr. I LPR: 1159/2017 dhe Nr. Ref. 176/2017 të datës 14.02.2017, i plotëson kushtet për përmbarim.

Ndaj këtij urdhri ka paraqitur prapësim debitori, duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin për përmbarim, duke i propozuar Gjykatës që ta aprovoje prapësimin e debitorit si të bazuar dhe të shfuqizoje urdhrin përmbarimor në tërësi.

Përgjigjen në prapësim ka parashtruar kreditori ndaj prapësimit të debitorit, duke i propozuar gjykatës që ta refuzojë prapësimin e debitorit si të pabazuar në tërësi dhe urdhrin përmbarimor P.nr.135/22 të datës 15.08.2022 ta lejë në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.2130/22 të datës 31.10.2023, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit të përmbarimit Messier 96 Sh.P.K., dhe ka anuluar urdhërin përmbarimor P.nr.135/22 të datës 15.08.2022 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Shala, me seli në Prishtinë dhe ka përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se pas analizimit të propozimit për përmbarim e konteston se i njëjti është lejuar mbi bazën e dokumentit përmbarimor- Kontratës për Qira Nr. I LPR: 1159/2017 dhe Nr. Ref. 176/2017 të datës 14.02.2017, të përcaktuar sipas vendimit në shumën prej 16,769.20€. Po ashtu, Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në rastin konkret, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 21, 22 dhe 26 të LPP-së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës përmbarimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbarimore.

Kjo gjykate vlerëson se ne rastin konkret Kontratës për Qira Nr. I LPR: 1159/2017 dhe Nr. Ref. 176/2017 të datës 14.02.2017, për shumën në lartësi prej 16,769.20€, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet për të qene dokument përmbarimor me tipare të përmbarueshmërisë, sepse nuk i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 69 dhe 71 par. 1.1 të LPP-së. Tutje, përmbarueshmëria e dokumentit noterial është e rregulluar sipas nenit 43 të Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë, ku në paragrafin 1 të po të njëjtit përcaktohet se "*1. Dokumenti noterial është dokument përmbarimor në qoftëse është përpiluar në formën e parapare dhe nëse në të është përcaktuar kryerja e detyrimit të caktuar për të cilën palët mund të merren vesh dhe nëse përmban deklaratën e detyruesit për atë që në bazë të atij dokumenti, mundet, e me qëllim të realizimit të detyrimit, pas arritshmërisë së detyrimit, në mënyre të drejtpërdrejt të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm.*"

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dokumenti mbi të cilin është lejuar përmbarimi, Kontratës për Qira Nr. I LPR: 1159/2017 dhe Nr. Ref. 176/2017 të datës 14.02.2017, nuk përben bazën juridike për caktimin e përmbarimit, pasi që sipas nenit 21 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, në të cilin përcaktohet se "*Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshme, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*" dhe nenit 22 par.1 pika 1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohen dokumentet përmbaruese siç janë "*Vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi*"., edhe neni 26 përcakton se :"*Dokumenti i noterizuar është i përmbarueshëm nëse është bërë i përmbarueshëm sipas rregullave të veçanta që rregullojnë përmbarueshmërin e atij dokumenti*". Ne rastin konkret Kontratës për Qira Nr. I LPR: 1159/2017 dhe Nr. Ref. 176/2017 të datës 14.02.2017, nuk i përmban elementet dhe nuk e ka cilësinë e dokumentit përmbarues sipas nenit 69 dhe 71 par. 1, LPP-së. Nenin 71 par. 1 përcakton se: Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: 1.1. "*dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë*", pra ky dokument përmbarimor nuk ka tipare të përmbarueshmërisë. Në rastin konkret gjykata drejt ka vlerësuar se kreditori ka kërkuar nga debitorit detyrim përtej çmimit të kontraktuar, andaj vlerëson se në këtë rast debitorit nuk konsiderohet të jetë në vonesë lidhur me detyrimin i cili nuk është i kontraktuar e në bazë të së cilës kreditori kërkon përmbushje të borxhit.

Andaj, Gjykata Komerciale – dhoma e shkallës së dytë vlerëson së gjykata e shkallës së parë drejte ka vendosur kur e ka pranuar në tërësi prapësimin e debitorit, me arsyetimin se në bazë të shkresave të lendes rezulton se vendimi mbi të cilin përmbaruesi privat e ka lejuar urdhrin përmbarimor të debitorit me Kontratës për Qira Nr. I LPR: 1159/2017 dhe Nr. Ref. 176/2017 të datës 14.02.2017, nuk paraqet dokument përmbarimor në kuptim të dispozitave të LPP-së, për shkak se sqarohet shumë kuart, që debitorit të jetë në vonesë duhet plotësuar kushti i caktuar me kontrate, e që rezulton të jenë detyrimet e përcaktuara me nenin 7 të kontratës me të cilën është kontraktuar se : "*Në rast se qiramarrësi nuk shlyen të gjitha detyrimet financiare që përcakton kjo kontrate për 2 (dy) muaj resht, kontrata konsiderohet e shkëputur dhe qiramarrësi, ndërpret aktivitetin, liron menjëherë objektin, duke mbajtur një procesverbal të veçantë për gjendjen e objektit në momentin e dorëzimit*", ndërsa nga shkresat e lëndës vërtetohet se kushti për inicim të procedurës përmbarimore nuk është përmbushur konform të sipër cekurave, se minimumi i kërkuar për qiranë e kontraktuar nuk korrespondon me minimumin e dakorduar nga palët nënshkruese të kontratës në fjalë.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të debitorit por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitorë për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e mos kryerjes së përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar prapësimin e debitorit dhe e ka lënë në fuqi urdhrin për caktimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat, P.nr.135/22 të datës 15.08.2022.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.17/24 dt. 07.06.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami d.v.